



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPI

SHTATOR 2015

Numër
falas



**GARAZHI NË KATE "TODOR ALEKSANDROV"
ZGJIDHJE PËR PROBLEMIN ME TRAFIKUN NË QENDËR**



GARAZHI NË KATE “TODOR ALEKSANDROV” ZGJIDHJE PËR PROBLEMET ME TRAFIKUN NË QENDËR



Si pjesë e përpjekjeve për zgjidhjen e problemit me parkimin në qendër, në rrugën Dame Gruev Qyteti i Shkupit ndërtoi garazhin modern në kate “Todor Aleksandrov”. Ky objekt bashkëkohor që siguron parking publik për 604 automjete të lehta, duke përfshirë edhe vendparksim për personat me nevojë të posaçme, si dhe parking për 120 biçikleta, u hap solemnisht më 8 Shtator.

- Më paraqet nder të veçantë që pikërisht sot, në Ditën e pavarësisë të Republikës së Maqedonisë – 8 Shtator edhe zyrtarisht ta hapim garazhin e ri në kate “Todor Aleksandrov”. Objekti është i gjatë 23 metra, ka bruto sipërfaqe prej 29,183 metra katror, si dhe përdhës, 7 kate mbi tokë dhe dy nivele nën tokë. Në përdhës dhe në katin e parë janë parashikuar vetëm hapësira afariste, kurse katet tjera janë ekskluzivisht për parkim. Hyrja në garazhin në kate për automjetet e lehta motorike është nga ana verilindore e

objektit, përmes rrugës nëntokësore e cila çon deri në nivelin e parë nëntokësor të garazhit. Dalja nga garazhi është nga niveli i parë nëntokësor përmes rrugës nëntokësore të pjesës juglindore të objektit, direkt në rrugën Dame Gruev. Lëvizja e automjeteve nëpër kate zhvillohet përmes tramit spiral. Në çdo kat është ndërtuar aneks dhe tualete për vizitorët, duke përfshirë edhe tualete për personat me nevoja të posaçme. Parkingu për biçikleta është i vendosur në pjesën e lakuar të objektit dhe deri atje mund të arrihet drejtpërdrejt përmes ashensorit të veçantë, si dhe përmes 3 ashensorëve të destinuar për vizitorët – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, në hapjen solemne të garazhit në kate “Todor Aleksandrov”.

Trajanovski shtoi se garazhi në kate “Todor Aleksandrov” është i pajisur me sistemet më moderne dhe më kualitative për detektimin dhe lajmërimin e vendeve të lira për parkim; sistem për pagimin e parkimit; videobikëqyrje me 87 kamera dhe dhomë kontrolli; sistem për mbrojtje kundër zjarrit; sistem për detektimin dhe lajmërimin e CO2 dhe gazit; sistem për mbrojtje nga shkarkime atmosferike, si dhe sistem për kondicionim dhe ventilim.

- Fasada e objektit është e mbuluar me qelq të laminuar sigurie. Hapësira rreth garazhit është rregulluar me parter. Projekti për garazhin në kate në rrugën Dame Gruev është i Institutit ndërtimor “Makedonija” SHA Shkup. Garazhin në kate e ndërtuan ndërtuesit e “Beton” SHA Shkup, kurse Qyteti i Shkupit për këtë punim të rëndësishëm ndau rreth 780 milion denarë. Me garazhin e ri në kate “Todor Aleksandrov” do të menaxhojë NP “Parkingu i qytetit” kurse parkimi do të kushtojë 30 denarë në orë – theksoi kryetari i qytetit Trajanovski.

Kryetari i Qeverisë të Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, theksoi se është kënaqësi e veçantë që pikërisht në 8-të Shtator u hap në mënyrë solemne garazhi në kate Todor Aleksandrov”.

Besoj se ky objekt i ri do t’i zgjidhë problemet afatgjate me parkimin në qendrën e qytetit dhe të njëjtin do ta shfrytëzojnë edhe banorët përreth edhe vizitorët e Shkupit – thekoi kryeministri Gruevski.



Ndërtohet kanalizim atmosferik në rrugën Boca Ivanova

VËRSHIMET NË NËNKALIMIN NË BUTEL DO TË MBETEN NË TË KALUARËN

Për të mundësuar largimin pa ndërprerje të ujërave atmosferik dhe për të penguar përmbytjet në mbikalimin në Butel ekipe të Qytetit të Shkupit ndërtojnë kanalizim të ri atmosferik përgjatë rrugës "Boca Ivanova", nga lumi Serava deri tek rrethrotullimi në Butel, si dhe në një pjesë të rrugës "Aleksandar Urdarevski", nga rrethrotullimi deri te rruga "Dushko Popoviq".

- Ndërtimi i këtij kanalizimi atmosferik të ri do të zgjidhë problemet shumëvjeçare me përcjelljen e ujërave atmosferik në këtë pjesë të qytetit, të cilat derdhen në pikën më të ulët të nënkalimit në Butel. Ky drejtim është një nga „pikat e zeza“ në qytet që u përmbyt edhe gjatë shirave të rrëmbyeshëm të verës së kaluar dhe shkaktuan probleme të mëdha për banorët e zonës përreth rrugëve "Boca Ivanova" dhe "Aleksandar Urdarevski", si dhe



ndërprerje të komunikacionit rrugor drejt lagjeve Butel dhe Radishani. Gjatë punëve ndërtimore për ndërtimin e kanalizimit

atmosferik të rrugës "Boca Ivanova", nga lumi Serava deri tek rrethrotullimi, në terren do të bëhen gërmime dhe do të vendosen tuba çeliku me profil 1.200 milimetra në gjatësi 782 metra. Punët ndërtimore do të zhvillohen nëpër anën lindore të rrugës, gjatë të cilave në këtë pjesë të rrugës do të vendoset regjim i përkohshëm i qarkullimit rrugor. Gjatë punëve ndërtimore për ndërtimin e

kanalizimit atmosferik të një pjese të rrugës "Aleksandar Urdarevski", në drejtimin nga rruga "Dushko Popoviq", do të vendosen tuba me profil 1.000 milimetra, në gjatësi 131 metra. Punët ndërtimore do të zhvillohen nga ana perëndimore e rrugës automobilistike, gjatë të cilave në këtë pjesë të rrugës do të vendoset regjim i përkohshëm i qarkullimit rrugor. Në ndërtimin e kanalizimit të ri atmosferik do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Karposh AD Skopje“, kurse punët ndërtimore duhet të përfundojnë për rreth 6 muaj. Për këtë projekt Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 34 milion denarë – tha kryetari Koce Trajanovski, në fillimin e punëve ndërtimore të kanalizimit të ri atmosferik, më 11 gusht.

Në Qytetin e Shkupit po punohet në përgatitjen e fazës ë dytë të projektit për ndërtimin e kanalizimit ri atmosferik të kësaj pjesë të qytetit, e cila duhet të përfshijë ndërtimin e kanalizimit atmosferik nëpër rrugën "Aleksandar Urdarevski", nga rruga "Dushko Popoviq" deri te rruga "Butelska", si dhe në një pjesë të rrugës "Butelska" deri te kryqëzimi me rrugën "Marko Krale".



SHUTO ORIZARE DO TË FITOJË SISTEM TË RI UJËSJELLËSI



Ndërtimi i sistemit të ri të furnizimit me ujë të pijshëm për komunën Shuto Orizare është në vijim. Këto ditë po punohet në mënyrë intensive në ndërtimin e rezervuarit në rrugën "Guadalajara", si dhe të stacionit të pompimit tek fabrika e mëparshme "TIPO" në bulevardin "Sllovenia". Ndërtimi i sistemit të ri të furnizimit me ujë të pijshëm në komunën Shuto Orizare filloi më 29 qershor të këtij viti, kurse fillimin e punëve ndërtimore e shpallën kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla

Gruevski, zëvendës-kryeministri i Qeverisë dhe ministri i financave, Zoran Stavreski, kryetari i Komunës Shuto Orizare, Elvis Bajram, deputeti i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Amdi Bajram dhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva.

- Vite me radhë furnizimi me ujë të pijshëm përbën një problem shumë të nxehtë për më shumë se 30.000 banorë të komunës Shuto Orizare. Me ndërtimin e këtij sistemi të furnizimit me ujë të pijshëm do të zgjidhen problemet shumëvjeçare me furnizimin me ujë të lagjeve Shuto Orizare

dhe të një pjese të lagjes Shkup veri. Për sistemin e ri të furnizimit me ujë të pijshëm do të ndërtohet rezervuar me kapacitet 4.350 metra kub në afërsi të rezervuarëve ekzistues të NP „Ujësijellës dhe kanalizim” në rrugën "Guadalajara"; stacion i ri pompimi tek fabrika e mëparshme "TIPO" në bulevardin "Sllovenia" dhe tubacion me gjatësi 2,3 kilometra dhe profil 500 milimetra që do të kalojë nga stacioni i pompimit, e pastaj nëpër rrugët "Shuto Orizare", "Vinička", "Çe Gevara", "Plačkovica" "Butelski venec". Stacioni i pompimit do të lidhet në linjën e furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit F 1.600 nga burimi Rashçe. Ndërtimi i ujësijellësit në komunën Shuto Orizare përbën projekt të përbashkët të Qytetit të Shkupit, NP „Ujësijellës dhe kanalizim” dhe Komunës Shuto Orizare – tha kryetari Koce Trajanovski.

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, deklaroi se ky është edhe një projekt nga vargu i projekteve, të cilat do të realizohen në territorin e komunës Shuto Orizare, me qëllim përmirësimin e kualitetit të jetës së banorëve të komunës.

Vlera e përgjithshme e investimit është 182.367.800 denarë me TVSH. Në financimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë me 43,7 për qind të mjeteve, përkatësisht me 79,7 milion denarë; NP „Ujësijellës dhe kanalizim”, gjithashtu, me 43,7 për qind, përkatësisht 79,7 milion denarë, kurse Komuna Shuto Orizare do të marrë pjesë me 12,6 për qind, përkatësisht 22,9 milion denarë të mjeteve të nevojshme financiare.

Qyteti i Shkupit mjetet financiare do t'i sigurojë nëpërmjet nën-kredisë afatgjatë vendase në suazat e Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale të financuar nga Banka ndërkombëtare për zhvillim dhe rinovim – Banka Botërore, përderisa NP „Ujësijellës dhe kanalizim” mjetet financiare do t'i sigurojë nga burime të veta.


Në ndërtimin e sistemit të ri të furnizimit me ujë të pijshëm në Shuto Orizare do të punojnë ekipet e kompanisë „Hidrostroy JSC” nga Bullgaria, kurse punët ndërtimore pritet të përfundojnë në vjeshtën e vitit 2016.

U zgjerua edhe një rrugë e rëndësishme automobilistike në qendrën e qytetit

TRI KORSI PËR RRUGËN “JORDAN MIJALKOV”

Kryetari Koce Trajanovski dhe kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, më 12 korrik hapën zyrtarisht për komunikacion rrugën “Jordan Mijalkov”, e cila periudhën e kaluar u zgjerua dhe u rinovua nga kryqëzimi me rrugën “German” deri para kryqëzimit me rrugën “Pavel Shatev”.

- Me zgjerimin, kjo rrugë e ngushtë dhe jofunksionale u bë me tri korsi rrugore me gjerësi nga 3,25 metra në një gjatësi 750 metra, korsi rrugore shërbyese me parking të gjerë 6 metra dhe me gjerësi 200 metra dhe trotuar të shtruar me pllaka begatoni. Rikonstruksioni i rrugës “Jordan Mijalkov” u shfrytëzua për vendosjen e kanalizimit



MË PARË



PASTAJ

të ri atmosferik, dhe u përfundua edhe rikonstruksioni i rrjetit ekzistues të ujësjellësit (F200) dhe ujërave të zeza (F300). Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës "Jordan Mijalkov" punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Pelagonija” nga Gostivari. Qyteti i Shkupit për punët ndërtimore të kësaj rruge automobilistike investoi rreth 43 milion denarë me TVSH. Rruga e re e zgjeruar ndriçohet nga 19 shtylla ndriçimi në të cilat janë vendosur 32 llamba. Në ndriçimin e rrugës "Jordan Mijalkov" punuan ekipet e "Digital DOO Strumica", kurse Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore shpenzoi rreth 2 milion denarë. Me këtë, vlera e përgjithshme e projektit për zgjerimin dhe rikonstruksionin e rrugës "Jordan Mijalkov", nga kryqëzimi me rrugën "German" deri para kryqëzimit me rrugën "Pavel Shatev" është rreth 45 milion denarë. Zgjerimi i rrugës "Jordan Mijalkov" në një masë të madhe do të kontribuojë për shkarkimin e komunikacionit rrugor nga qendra e qytetit drejt lagjes Kisela Voda dhe do të shkurtohet koha e udhëtimit nga lagja Karposh deri në Kisela Voda dhe drejt lagjes Aerodrom – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen zyrtare për komunikacion të kësaj rruge automobilistike të rëndësishme.

Kryeministri Nikolla Gruevski para të pranishmëve theksoi se zgjerimi i kësaj rruge është një punë ndërtimore e rëndësishme dhe është pjesë e një plani të madh me realizimin e të cilit do të mundësohet shkarkimi i komunikacionit rrugor në këtë pjesë të qytetit.



Po zgjerohet edhe një grykë e ngushtë e komunikacionit rrugor

RRUGA "MAXHARI" VITIN E ARDHSHËM DO TË KETË KATËR KORSI



Rruga "Maxhari" në komunën Gazi Baba vitin e ardhshëm do të ketë katër korsi rrugore nga kryqëzimi me rrugën "Juzhnomoravski brigadi" deri në rrugën "Palmiro Toliati", në gjatësi 666 metra. Punët ndërtimore për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e kësaj pjese të rrugës, të cilat filluan më 18 qershor zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

- Me zgjerimin, kjo rrugë e ngushtë dhe jofunksionale do të ketë katër korsi rrugore me gjerësi nga 3,25 metra, nga dy korsi në çdo drejtim, dhe trotuare të reja të shtruara me pllaka begatoni. Nga ana e majtë e rrugës "Maxhari", e shikuar nga mbikalimi, do të formohet korsi biçikletash me gjerësi 3 metra dhe korsi për këmbësorë me gjerësi 1,5 metra. Nga ana e djathtë e kësaj rrugë do të formohet korsi këmbësorësh me gjerësi 2 metra. Në pjesën e re të zgjeruar do të vendoset edhe ndriçim i ri rrugor. Punët ndërtimore për zgjerimin e rrugës "Maxhari" në këtë drejtim do të shfrytëzohen për të vendosur kanalizim të ri atmosferik nga kryqëzimi i rrugës "Juzhnomoravski brigadi" me rrugën "Metodija Andonov Çento" deri te mbikalimi në Maxhari, i cili do të zgjidhë problemin shumëvjeçar me largimin e ujërave atmosferik. Në një gjatësi të përgjithshme prej 929 metra do të vendosen tuba polietileni me profil 200, 800 dhe 1.000 milimetra – tha kryetari Koce Trajanovski, në fillimin e punëve ndërtimore për zgjerimin e rrugës "Maxhari".

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski, para të pranishmëve theksoi se rruga "Maxhari" është një rrugë me frekuencë të madhe në të cilën ndodhen shumë institucione dhe, se me zgjerimin e saj do të përmirësohet komunikacioni rrugor në këtë pjesë të qytetit.

Projekti për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e rrugës "Maxhari" do të realizohet në dy faza. Në zgjerimin në këtë fazë të parë të rrugës "Maxhari", nga kryqëzimi me rrugën "Juzhnomoravski brigadi" deri në rrugën "Palmiro Toliati" dhe kanalizimin atmosferik do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG“. Qyteti i Shkupit për këtë projekt voluminoz do të investojë rreth 52 milion denarë.

Gjatë kohës që zgjasin punët ndërtimore në rrugën "Maxhari" është vendosur regjim i përkohshëm i qarkullimit rrugor. Qyteti i Shkupit apelon deri te qytetarët të respektojnë sinjalizimin rrugor dhe të përshtatin shpejtësinë me kushtet e rrugës.

ASFALT I RI PËR NJË PJESË TË RRUGËS “KEMAL SEJFULLA”

Rruga “Kemal Sejfulla” së shpejti do të shtrohet me asfalt të ri, nga kryqëzimi me rrugët “Ferid Bajram” dhe “Vtora makedonska brigada” deri në kryqëzimin me rrugën “Bosna i Hercegovina”.

- Bëhet fjalë për rikonstruksionin e rrugës automobilistike të një pjese të rrugës “Kemal Sejfulla” me gjatësi të përgjithshme 375 metra. Ky rikonstruksion përbën vazhdimin e projektit për rinovimin e kësaj rruge, që Qyteti i Shkupit e realizoi në vitin 2010, kur rruga u rinovua nga kryqëzimi me bulevardin “Xhon Kenedi” deri në kryqëzimin me rrugët “Vtora makedonska brigada” dhe “Ferid Bajram”. Tani, gjatë punëve ndërtimore të kësaj pjese të rrugës “Kemal Sejfulla” do të mënjanohet asfalti i vjetër, do të nivelohen 22 puseta dhe vendgrumbullime, do të zëvendësohen bordurat e dëmtuara, ku do të ketë nevojë do të fuqizohet edhe shtresa bartëse, dhe pastaj në rrugën automobilistike do të shtrohet asfalt i ri, dhe do të shënohet sinjalizimi horizontal – deklaroi kryetari Koce Trajanovski.

Rikonstruksioni i kësaj rruge do të kontribuojë në rritjen e sigurisë në zhvillimin e komunikacionit rrugor në këtë pjesë të qytetit.

Punët ndërtimore për rikonstruksionin e kësaj pjese të rrugës “Kemal Sejfulla” do t’i kryejë kompania e ndërtimit „JU BAJ”. Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore do të investojë rreth 4,5 milion denarë.



PO RINOVHET RRUGA AUTOMOBILISTIKE EDHE NË BULEVARDIN “JANE SANDANSKI”



Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë po rinovojnë rrugën automobilistike në bulevardin „Jane Sandanski”, në drejtimin nga garazhi me kate „Ilinden” deri në kryqëzimin me rrugën „Vasko Karangelevski”.

- Ky projekt është vazhdim i projektit për rikonstruksionin e bulevardit “Jane Sandanski”, që Qyteti i Shkupit e realizoi në vitin 2012, kur ky bulevard u shtrua me asfalt të ri nga kryqëzimi me bulevardin “Serbia” deri në kryqëzimin me garazhin me kate „Ilinden”. Tani, gjatë punëve ndërtimore në bulevardin “Jane Sandanski” do të mënjanohej shtresa e dëmtuar e asfaltit të vjetër ekzistues me gjatësi 475 metra, do të nivelohen 37 puseta dhe vendgrumbullime, do të zëvendësohen bordurat e dëmtuara, në vendet ku do të shfaqet nevoja do të rinovohet edhe shtresa bartëse, dhe pas kësaj në rrugën automobilistike do të shtrohet asfalt i ri Split Mastiks me origjinë eruptive në një sipërfaqe prej 9.000 metra katrorë. Gjatë punëve ndërtimore do të rinovohet edhe një pjesë e korsisë së biçikletave nga të dyja anët e bulevardit – shpjegon kryetari Koce Trajanovski.

Në fazën e dytë të projektit për rikonstruksionin e rrugës automobilistike në bulevardin “Jane Sandanski” punojnë punëtorët e kompanisë „Eskavatori – MK”. Qyteti i Shkupit për këtë punë ndërtimore do të shpenzojë rreth 17,2 milion denarë.



PO ZGJEROHET KRYQËZIMI I RRUGËVE “BLAGOJA STEFKOVSKI” DHE “ZHAN ZHOES”

Punët ndërtimore për zgjerimin e kryqëzimit të rrugëve “Blagoja Stefkovski” dhe “Zhan Zhores”, në lagjen Maxhari, komuna Gazi Baba, janë në vijim.

- Ky kryqëzim vite me radhë përbënte pikë të zezë të komunikacionit rrugor, në të cilën krijohet kaos i madh dhe formohen kolona automjesh, veçanërisht gjatë kthimit drejt lagjes Çento. Tani, rruga “Blagoja Stefkovski” gjatë hyrjes në kryqëzim do të zgjerohet dhe do të formohet një korsi e veçantë për kthim majtas dhe një korsi e veçantë për lëvizje drejt, nga të dyja anët e kryqëzimit. Rruga automobilistike e zgjeruar në kryqëzim do të jetë me sipërfaqe rreth 1.200 metra katrorë. Me këtë projekt, do të mundësohet shkarkimi i komunikacionit rrugor në këtë kryqëzim, do të shkurtohet koha e udhëtimit dhe do të kontribuohet në mbrojtjen e ambientit jetësor. Në zgjerimin e kryqëzimit të rrugëve “Blagoja Stefkovski” dhe “Zhan Zhores”, në lagjen Maxhari, do të punojnë ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica”, kurse për realizimin e këtij projekti Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 4,5 milion denarë. Punët ndërtimore pritet të përfundojnë për rreth 2 muaj. Apeloj deri te qytetarët për durim gjatë kohës që vazhdojnë punët ndërtimore në këtë kryqëzim dhe të përshtatin shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Gjatë punëve ndërtimore për zgjerimin



e kryqëzimit ndërmjet rrugëve “Blagoja Stefkovski” dhe “Zhan Zhores” në terren po bëhen gërmime dhe po vendoset shtresa e tamponit, pas së cilës rruga e re e zgjeruar do

të asfaltohet dhe do të shënohet sinjalizimi horizontal.

Pas zgjerimit të kryqëzimit do të rregullohen edhe trotualet.



„SHKUPI“

LAJMËTARI INFORMATIV I

QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ

„Shkupi“ u botua më:

10 dhjetor 2008

Redakton

Seksioni për marrëdhënie me publikun
i Qytetit të Shkupit

www.skopje.gov.mk

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

Bulevardi Ilinden 82

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botol:

Nampres, Shkup

SHESH I RI PO NDËRTOHET PARA KISHËS „SHËN MARIA”

Ekipe të Qytetit të Shkupit punuan intensivisht në projektin për formimin e sheshit para kishës „Shën Maria”, në hapësirën e rrugës ekzistuese „Dimitar Vlahov”, nga bulevardi „Filip vtori makedonski” deri në bulevardin „Krste Misirkov”, me sipërfaqe të përgjithshme 5.500 metra katrorë. Me këtë projekt, rruga „Dimitar Vlahov” do të transformohet në zonë këmbësorësh. Sipërfaqja do të shtrohet me gurë graniti, dhe pastaj, në sheshin e ri të formuar do të vendosen stola, kosha për mbeturina dhe dy çezma për të pirë ujë.

Në shesh do të vendoset edhe ndriçim i ri. Për të mundësuar qasjen e automjeteve të ndihmës së shpejtë, në hyrjen e sheshit do të vendosen shtyllëza hidraulike metalike.

Muri i bregut, do të vishet me mermertë bardhë, dhe pastaj në të do të montohet rrethimi mbrojtës prej hekuri të kalitur, me lartësi 75 centimetër.

Punët ndërtimore do t'i realizojë kompania e ndërtimit „Urbaninvest”. Qyteti i Shkupit për realizimin e projektit për formimin e sheshit para kishës „Shën Maria” do të ndajë rreth 34,3 milion denarë me TVSH.





SHATËRVANI I RI ATRAKSION I SHESHIT „MAQEDONIA”

I rregulluar në hapësirën ndërmjet shatërvanit „Luftëtari në kalë” dhe hyrjes në Urën e gurit shatërvani i ri sipërfaqësor në sheshin „Maqedonia” është një atraksion i vërtetë.

Bëhet fjalë për shatërvan sipërfaqësor, të ashtuquajtur shatërvan i thatë me formë drejtkëndëshi dhe me dimensione 20 x 10 metra dhe me shtrat prej betoni të armuar të groposur. Sipërfaqja mbi betonin e armuar është përgatitur nga pllaka graniti ndriçuese me dimensione 60 x 60 centimetra dhe me trashësi 10 centimetra.

Në pllakat e shatërvanit janë vendosur llamba LED me vrima për daljen e currilave të ujit. Shatërvani përbëhet nga 128 currila me 128 llamba, si dhe 16 spërkatëse parabolike të laminuara. Efekti vizual i shatërvanit arrihet me lojën e currilave, kurse në mbrëmje edhe me lojën e llambave.

Uji që del nëpërmjet currilave depërton nëpër pllaka dhe përsëri kthehet në sistem.



U vendos sistemi i ri për pagimin e biletave në transportin publik

Qyteti i Shkupit nga 1 shtatori vendosi sistem të ri për pagimin e biletave në autobusët e NQP-së. Deri më datën 31.12.2015 mënyra e re e pagimit do të funksionojë si provë, dhe deri atëherë qytetarët do të duhet të zëvendësojnë biletat e vjetra prej letre dhe kartat e lira të autobusit me karta të reja elektronike. Tashmë nga data 01.01.2016 biletat e vjetra prej letre, kartat e lira dhe pagimi kesh do të kalojnë në histori dhe në autobusët e transportit publik do të përdoren vetëm kartat e reja elektronike. Duke filluar nga data 01.01.2016, me kartat e reja elektronike qytetarët do të kenë mundësi të udhëtojnë edhe në autobusët e NQP-së edhe në autobusët e transportuesve privatë, sepse në këtë sistem do të përfshihen edhe transportuesit privatë.

- Deri më datën 31.12.2015 do të funksionojnë paralelisht edhe sistemi i vjetër edhe ai i ri për pagimin e biletave të udhëtimit, përkatësisht, në autobusët e transportit publik do të përdoren edhe biletat prej letre dhe kartat e lira edhe kartat e reja elektronike. Por, nga 1 janari i vitit 2016, në autobusë do të zbatohet vetëm sistemi i ri i pagimit, i cili do të ofrojë përfitime të mëdha edhe për qytetarët edhe për transportuesit – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Më shumë informacione në lidhje me sistemin e pagimit elektronik në NQP dhe mënyrën e funksionimit të kartave të

ZËVENDËSONI BILETAT E LETRËS DHE



EKZISTOJNË DY TIPA KARTASH ELEKTRONIKE

Ekzistojnë 2 tipa kartash elektronike, Kartë e personalizuar elektronike dhe Kartë e papersonalizuar elektronike, ose e thënë më thjeshtë, kartë e cila përmban të dhënat dhe fotografinë e udhëtarit dhe kartë e cila nuk përmban të dhënat dhe fotografinë e udhëtarit. **Nëse doni të posedoni biletë për nxënës, studentë, pensionistë, ose mujore për të punësuar, atëherë është e domosdoshme të nxirrni kartë të personalizuar.** Kartën e personalizuar mund ta blini kur të doni dhe ta mbushni dhe kontrolloni nëpërmjet aplikacionit UEB. Nëse karta e personalizuar humbet, ekziston mundësia për ta bllokuar dhe nuk mund ta shfrytëzojë person tjetër, kurse mjetet mund t'ju barten në kartën tjetër. Karta e papersonalizuar mund të shfrytëzohet nga më shumë persona dhe ajo ka funksionin e kartës familjare. Nëse e humbisni, nuk keni mundësi për ta bllokuar dhe mjetet e plotësuara në të nuk mund të rimbursohen.

reja, qytetarët mund të marrin në portalin e internetit www.skopska.mk, si dhe në linjën telefonike falas 0 800 15 115.

Paralelisht me sistemin për pagimin elektronik, në automjetet e NQP-së zbatohet

edhe sistemi për lokacionin automatik të automjeteve, me të cilin do të mundësohet ndjekja e lëvizjes së çdo autobusi, nga stacioni i fillimit deri te stacioni i fundit. Në stacionet e autobusit do të vendosen mbi

50 ekrane informative nëpërmjet të cilave udhëtarët do të informohen për arritjen e autobusëve, dhe do të jenë në dispozicion edhe mjete të tjera komunikimi për informim, marrja e informacionit nëpërmjet mesazheve SMS. Ky sistem mundëson nga qendra e kontrollit të ndiqen autobusët në kohë reale nëse i përmbahen orarit të udhëtimit të përcaktuar, hapet mundësia për korrigjime në kohë dhe zvogëlimin e kohës së pritjes në përputhje me gjendjen aktuale të komunikacionit rrugor nëpër rrugët e qytetit, dhe do të ketë një pamje reale për numrin e udhëtarëve të transportuar sipas kategorive, korridoreve, linjave dhe stacioneve të autobusit.

Sistemi për lokacionin automatik të automjeteve dhe për pagimin elektronik duhet të instalohet në 500 autobusë të transportit publik. Ky sistem deri tani



KARTAT E LIRA ME KARTA ELEKTRONIKE

SI TË BLINI KARTË ELEKTRONIKE

Kartën elektronike të personalizuar mund ta blini në 8-të qendra informuese në lokacione të ndryshme të qytetit, si vijon: tek Qendra transportuese; në lagjen Aerodrom, në ndërtesën përballë Qendrës tregtare „Biser”; në ambientet e JSP TURS në rrugën „Dame Gruev”; në



lagjen Karposh, në stacionin përballë hotel „Karposh”; në Bit Pazar, në stacionin tek hoteli „Sultan”; në qendrën informative në Porta Vllae; në drejtorinë e NQP-së në Autokomandë, në stacionin tek Fakulteti i pyjeve. Tetë qendrat informuese të NQP-së janë shënuar qartë me pllakate me bojë të verdhë, me nënshkrimin SKOPSKA.

Procedura për nxjerrjen e Kartës elektronike të personalizuar është si vijon: vini në qendrën informuese, identifikoheni dhe dorëzoni dokumentet e nevojshme nëse aplikoni për blerjen e biletës së privilegjuar; tregoni për cilën biletë aplikoni; operatori në qendrën informuese fut të dhënat tuaja në sistem dhe ju fotografon; në një printer special printohet karta juaj dhe pas pagimit, të kryer tashmë, keni përgatitur kartë elektronike në të cilën është regjistruar biletë. Procedura zgjat rreth dy minuta.

Kartën elektronike të papersonalizuar mund ta blini në tetë qendrat informuese, në 60 vende shitjeje në qytet, si dhe në 3 automate për nxjerrjen e pavarur dhe plotësimin e kartave të cilat do të vendosen së shpejti. Procedura është si vijon: blerja e kartës elektronike të zbrazur; kartën elektronike të zbrazur e plotësoni me një vlerë të caktuar dhe me këtë karta juaj merr funksionin e kartës elektronike; plotësimi nuk mund të jetë më pak se 100 denarë.

KARTË ELEKTRONIKE DHE BILETË ELEKTRONIKE

Karta elektronike është kartë plastike me çip, e ngjashme me kartat e bankave. Bileta elektronike, nga ana tjetër, është prodhimi që është vendosur në kartën tuaj elektronike, për shembull biletë mujore, biletë për 10 udhëtime, portofol elektronik me mundësi për mbushje...

IDENTIFIKUESI

Ai është një aparat me të cilin lexohet karta dhe gjendet në hyrjen e autobusëve të qytetit. Çdo udhëtar është i obliguar të regjistrojë kartën e vet gjatë çdo hyrjeje në autobus gjë me të cilën do të merren të dhëna për qarkullimin e udhëtarëve në autobusë në çdo kohë, në stacione apo linja të caktuara, duke mundësuar harmonizimin e orareve të udhëtimit dhe sigurimin e kualitetit më të mirë të transportit të udhëtarëve.

KOHA E IDENTIFIKIMIT

Kartën elektronike e afroni tek identifikuesi dhe vetëm për 2 sekonda sistemi verifikon nëse karta është vlefshme apo jo (i ka kaluar afati, e dëmtuar, pa kredi të mjaftueshme). Nëse karta është e rregullt identifikuesi sinjalizon me ngjyrë të gjelbër. Nëse karta është e parregullt – identifikuesi do të sinjalizojë me ngjyrë të kuqe.

PËR PENSIONISTËT – 4 DITË TRANSPORT FALAS

Me vendosjen e sistemit të ri për pagimin elektronik në autobusët e NQP-së, qytetarët e moshuar mbi 62 vjeç për gra, dhe mbi 64 vjeç për burra do të duhet të nxjerrin kartë elektronike të personalizuar, e cila gjatë çdo hyrjeje në autobusët e transportit publik do të duhet të regjistrohet në identifikues. Nxjerrja e kartës së personalizuar do të kushtojë 200 denarë.

Qytetarët e moshuar edhe më tej do të kenë mundësi të udhëtojnë falas në autobusët e NQP-së të martën, të premten, të shtunën dhe të dielën.

është instaluar në 385 autobusë të NQP-së, dhe do të instalohet edhe në 115 autobusë të transportuesve privatë.

Projekti për vendosjen e sistemit për lokacionin automatik të automjeteve dhe për pagimin elektronik është financuar plotësisht nga Qyteti i Shkupit, dhe kushton rreth 3 milion euro.



35 BIÇIKLETA - DONACION NGA AMSM-JA PËR QYTETIN E SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski dhe drejtori i NP „Parkingu i qytetit“, Borçe Jakimovski më 19 qershor morën në dorëzim donacionin prej 35 biçikletash nga Lidhja e automjeteve-motorike të Maqedonisë - AMSM.

- Dua të shpreh falënderimin deri te Lidhja e automjeteve-motorike të Maqedonisë për këtë donacion të biçikletave, me të cilin u përfshinë direkt në fushatën për përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit dhe ngritjes së vetëdijes publike për biçikletën si mjet transporti në Shkup. Këto 35 biçikleta, nga të cilat 30 janë biçikleta për të rritur, dhe 5 për fëmijë, kanë një vlerë rreth 172.000 denarë. Biçikletat e dhuruara Qyteti i Shkupit do t'i vendosë në punktet për huazimin e biçikletave të NP „Parkingu i qytetit“, para garazhit me kate „Makedonska falganga“ – tha kryetari Koce Trajanovski, gjatë dorëzimit të donacionit.

Drejtori i Lidhjes së automjeteve-motorike të Maqedonisë, Dimitar Minovski, deklaroi se këto biçikleta janë marrë nga projekti i Asociacionit botëror të komunikacionit rrugor (FIA), me të cilën u përfshinë në aktivitetet e Qytetit të Shkupit për promovimin e biçikletës si mjet transporti në Shkup.



„Me biçikletë në rrugë nëpër të gjithë qytetin“

DEFILE E MADHE BIÇIKLETASH NË RRUGËT E QYTETIT

Më 28 qershor nëpër rrugët e qytetit u mbajt defileu i biçikletave që përbën aktivitetin përfundimtar të projektit të Lidhjes së automjeteve-motorike të Maqedonisë „Me biçikletë në rrugë nëpër të gjithë qytetin“. Qëllimi i këtij projekti është promovimi i biçikletës si mjet transporti, si dhe ngritja e vetëdijes tek pjesëmarrësit e tjerë në komunikacionin rrugor se edhe çiklistët duhet të respektohen si pjesëmarrës të barabartë në komunikacionin rrugor.

Defileu i biçikletave filloi para „Porta Makedonija“ dhe lëvizte deri te ambientet e AMSM-së, pastaj nëpër bulevardin „Mitropolit Teodosij Gologanov“ deri te „Vero Taftalixhe“, nëpër bulevardin „8. Septemvri“ deri te „Mi-Da Motors“, dhe pastaj nëpër bulevardin „Ilinden“ deri në destinacionin përfundimtar tek „Guaska“ në parkun e Qytetit.

Ky projekt u përkrah nga Qyteti i Shkupit, kurse në defileun e biçikletave mori

pjesë edhe kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

- Qyteti i Shkupit u përfshi në projektin „Me biçikletë në rrugë nëpër të gjithë qytetin“ sepse është i orientuar nga promovimi i biçikletës si mjet transporti. Në suazat e këtij projekti, AMSM-ja, Qytetit të Shkupit, më saktë NP „Parkingu i qytetit“ i dhuroi 35 biçikleta, të cilat do të jenë në dispozicion të qytetarëve për huazim. Qyteti i Shkupit jo shumë kohë

më parë promovoi projektin „Shkupi qyteti i biçikletave 2017“ dhe vitet e ardhshme do të punojmë në mënyrë intensive në përmirësimin e infrastrukturës së çiklizmit dhe në përmirësimin e plotë të kushteve për udhëtim me biçikletë në Shkup – tha kryetari Trajanovski.

Defileu i biçikletave përfundoi tek „Guaska“ në parkun e qytetit, ku u mbajt koncert muzikor, kurse pesë pjesëmarrësve më me fat në defileu iu dhanë biçikleta „Max“.



Në garazhin me kate „Makedonska falanga”

U HAP STACIONI PËR MBUSHJEN E AUTOMJETEVE ELEKTRIKE

Pronarët e elektromobilave më 9 korrik mund të shfrytëzojnë stacionin e ri për mbushjen e automjeteve elektrike, i cili është vendosur në katin e parë të garazhit me kate „Makedonska falanga”, në rrugën „Sveti Kiril i Metodij”.

- Ky stacion është i destinuar për mbushjen e të gjitha llojeve të elektromobilave (automobil, skuter, elektrobicikletë) dhe ka dy lidhje për mbushje të njëkohshme me fuqi të përgjithshme 22 KW për lidhje. Një elektroautomobil mbushet plotësisht për rreth 30 minuta, ndërsa me këta automobila shpenzimi për udhëtim për 100 kilometra është rreth 50 denarë. Qyteti i Shkupit do të vazhdojë me projekte me të cilat do të përmirësohet elektro-mobiliteti dhe në periudhën e ardhshme do të blihet një automjet i tillë për nevojat e Qytetit të Shkupit, dhe do të vazhdojë procesi i vendosjes së mbushësve të tillë në parkingjet e NP „Parkingu i qytetit” – tha kryetari Koce Trajanovski, në hapjen zyrtare të stacionit.

Me promovimin e stacionit për mbushjen e automjeteve elektrike, „ProKredit Banka AD Skopje” promovoi 5-së elektromobilat e rinj që i bleu për nevoja komerciale në punën e përditshme, gjë me të cilën u bë kompania e parë në Maqedoni që përdor elektromobila.

Kryetari Trajanovski, për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe promovimin e elektro-mobilitetit në Republikën e Maqedonisë, ndau mirënjohje për:

- ProKredit Banka AD Skopje (kompania e parë në Maqedoni e cila ka blerë 5 automobila elektrikë për nevoja komerciale në punën e përditshme)

- Vanço Zërncev (për automjetin „Matiz” të adaptuar në automobil elektrik), dhe

- Sasho Jovanovski (për automjetin „Çinkueçento” të adaptuar në automobil elektrik)

Stacioni për mbushjen e automjeteve elektrike në garazhin me kate „Makedonska falanga” është i pari i këtij lloji në Shkup.



PAMJE E RE PËR PARKUN E NATYRËS „GAZI BABA”



Ekipet e Qytetit të Shkupit dhe të NP „Rrugë dhe rrugica” muajin e kaluar ndërtuan dy korsi të reja rekreacioni në parkun e natyrës „Gazi Baba” dhe rregulluan ambientin me vend-panorama, pajisje urbane dhe përmbajtje argëtuese.

Është kënaqësi e veçantë për mua që vetëm për disa muaj ky vend i preferuar nga shkupjanët u rregullua dhe mori një pamje të re. Pikërisht, ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica” ndërtuan këtë korsi rekreacioni të re në parkun e natyrës „Gazi Baba” e cila shtrihet nga Fakulteti i shkencave të natyrës drejt lagjes Hekurana, nga ana e Çairit. Korsia është e gjatë 1.200 metra, dhe e gjerë 2,6 deri në 3 metra, në varësi të kushteve të terrenit. Është e shtruar me zhavorr të bardhë, kurse përgjatë saj janë vendosur 3 stacione pushimi me elemente fitnes, elemente rekreative për fëmijë, 15 komplete stolash druri me tavolina, çezma për ujë dhe 4 vend-panorama. Në mënyrë plotësuese, është rregulluar edhe një korsi tjetër rekreacioni me gjatësi 400 metra dhe gjerësi 3 metra, e cila çon nga Fakulteti i shkencave të natyrës deri te kopshti i mëparshëm për fëmijë i Gazi Babës. Kjo korsi është shtruar me asfalt dhe është e ndriçuar. Për ndriçimin e kësaj korsie janë vendosur 31 shtylla ndriçimi me lartësi 5 metri dhe me 31 llamba me fuqi 50W. Janë vendosur edhe 4 shtylla me lartësi 10 metra në të cilat janë montuar 4 reflektorë për ndriçimin e terrenit të futbollit dhe 2 reflektorë për ndriçimin e terrenit për basketboll, me fuqi 250W. Ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim”, nga ana tjetër, punuan në rregullimin e gjelbërimit dhe vendosjen e elementeve rekreative. Rregullimi i Parkut të natyrës „Gazi Baba” do të mundësojë kushte më të këndshme për qëndrimin e qytetarëve në natyrë dhe do të ofrojë përmbajtje të reja për pushim dhe rekreacion. Në këtë projekt për rregullimin e Parkut të natyrës „Gazi Baba” Qyteti i Shkupit investoi rreth 6,6 milion denarë ose më saktë, për ndërtimin e dy korsive të rekreacionit shpenzoi rreth 3 milion denarë; për elementet rekreative – rreth një milion denarë; kurse për ndriçimin – 2,6 milion denarë – tha kryetari Koce Trajanovski, në promovimin e korsive të reja të rekreacionit në Parkun e natyrës „Gazi Baba”, që u mbajt më 10 gusht.



U RREGULLUA PJESA E DYTË E PARKUT „MAQEDONIA”



PASTAJ



MË PARË

Pjesa e dytë e Parkut „Maqedonia”, që shtrihet përgjatë bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov”, në qershor të këtij viti mori një pamje të re dhe të rregulluar.

- Në këtë park ka sipërfaqe të gjelbër me sipërfaqe rreth 32 000 metra katrorë, e cila më parë ishte lënë pas dore dhe kishte plepa, që ishin të vjetër dhe përbënin kërcënim për kalimtarët dhe për pushuesit. Në suazat e parkut është formuar edhe një korsi rekreacioni me zhavorr të bardhë dhe një korsi e asfaltuar me 48 stola për ndenje, kosha për mbeturina dhe pajisje të tjera urbane. Janë vendosur edhe 3 vend panorama, kurse në njërën prej tyre janë vendosur 4 tabela shahu prej mermeri. Në park ka përmbytje të destinuara për fëmijë – janë vendosur rekuizita për fëmijë prej druri,

spërkatëse me të cilat ujitet gjelbërimi, kurse në vjeshtë dhe në pranverë planifikojmë të mbjellim rreth 800 fidanë, nga të cilët rreth 300 drurë do të jenë gjetherënës, kurse rreth 500 halorë dhe atëherë parku do të marrë pamjen e vërtetë. Për rregullimin e pjesës së dytë të Parkut „Maqedonia” nga Buxheti i Qytetit të Shkupit janë ndarë rreth 15 milion denarë – shpjegon kryetari Koce Trajanovski.

Në rregullimin e kësaj

rekuizita ekologjike në formën e kalasë, kurse në një pjesë të korsisë së rekreacionit ka edhe vegla fitnes për tu ushtruar. Në pjesën e dytë të Parkut „Maqedonia” është vendosur rrjet i ri hidrant me 192

sipërfaqeje të re të gjelbër përgjatë bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” punuan ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim” dhe të NP „Rrugë dhe rrugica”.

Për ndriçimin e sipërfaqes së re të parkut të rregulluar, janë vendosur 15 shtylla të emaluara me lartësi nga 6 metra, me nga një llambë me fuqi 70 W, kurse në 4 shtyllat ekzistues janë vendosur reflektorë për ndriçimin e korsive që kryqëzohen. Në vendosjen e ndriçimit në pjesën e dytë të Parkut „Maqedonia” punuan ekipet e „ELTRA DOOEL Skopje”, kurse për realizimin e kësaj pjesë të projektit Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth një milion denarë.



Në Vodno

U RINOVUA KORSIA E ALPINIZMIT „SLOVENSKA”



Adhuresit e natyrës dhe të sporteve të alpinizmit mund të relaksohen në korsinë e këmbësorëve-alpinizmit të rinovuar „Slovenska”, e cila në qershor të këtij viti mori një pamje të re, nga stacioni policor „Vodno” deri në Vodnon e mesme. Korsinë e rinovoi Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Federatën e sporteve të alpinizmit dhe me NP „Parqe dhe gjelbërim” për të përmirësuar kushtet për sport dhe rekreacion në Shkup, për rritjen e sigurisë dhe qasjes dhe për përshtatjen e korsisë me normat europiane

dhe botërore për korsitë këmbësorësh-alpinizmi.

Korsia e rinovuar fillon në 320 metra lartësi mbi nivelin e detit, dhe përfundon në parkingun në Vodnon e Mesme në 580 metra lartësi mbi nivelin e detit. Ndryshimi në lartësi nga starti deri në fundin e korsisë është 260 metra lartësi mbi nivelin e detit, me pjerrësi mesatare 12

për qind, gjatësi të përgjithshme 2.100 metra dhe kohë kalimi prej 40 minutash.

Gjatë rikonstruksionit, në korsitë u vendosën 34 shkallë të reja druri, dhe janë rinovuar 30 shkallë ekzistuese.

Për lëvizjen e sigurt nëpër korsitë në tre vende është vendosur rrethim mbrojtës, me dimensione 1x15 metra, 1x4 metra dhe 1x3 metra.

Në korsitë janë vendosur edhe shtatë udhërrëfyes, katër tabela informuese, nga të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, dhe dy në gjuhën angleze (dy në startin tek parkingu në rrugën „Todor Aleksandrov”, në afërsi të stacionit policor dhe dy në Vodnon e Mesme).

Për një shikim më të mirë korsia është shënuar me tregues dhe me bojë të kuqe dhe të bardhë.

U PASURUAN ME PESHQ UJËRAT E LUMIT VARDAR

Nën organizimin e Qytetit të Shkupit, GEF (Fondi global për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe natyrës), Institutit për blegtori - Seksioni për peshkim dhe Federatës maqedonase të peshkimit më 18 qershor në ujërat e lumit Vardar, tek hoteli „Aleksandar Palas”, u lëshuan 5.000 copë troftë endemike maqedonase (Salmo macedonikus, Karaman, 1924).

Qëllimi i këtij projekti është mundësimi i mbrojtjes së troftës maqedonase dhe të llojit vretenar dhe rritja e numrit të popullatës së tyre në ujërat e Maqedonisë.



NDIHMË PËR TË PËRMBYTURIT NË REGJIONIN E TETOVËS



Pas motit të stuhishëm dhe përmbytjeve që goditën regionin e Tetovës dhe rrethinat e tij muajin e kaluar Qyteti i Shkupit dërgoi një ekip për ndihmë teknike dhe mekanizim për pastrimin e pasojave nga uji i vërsuar. Që në mbrëmjen e 4 gushtit Qyteti i Shkupit dërgoi dy cisterna për tërheqjen e ujit dhe shtatë cisterna për furnizimin me ujë nga NP „Ujësjellës dhe kanalizim” dhe NP „Higjiena komunale”, tre automjete zjarrfikëse të pajisura me pompa të fuqishme për pompimin e ujit, si dhe disa pompa me kapacitet të madh për pompimin e ujit.

Për Tetovë u nis edhe një ekip me mbi 70 persona, i përbërë nga zjarrfikës

të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit, anëtarë të Shtabit për mbrojtje dhe shpëtim të Qytetit të Shkupit, si dhe të punësuar në ndërmarrjet publike të Qytetit të Shkupit. Ekipet e Qytetit të Shkupit pastruan baltën dhe lymin nga rrugët automobilistike në Tetovë dhe në regjion, dhe pastruan edhe rrjetin e kanalizimit atmosferik dhe të ujërave të zeza.

Në terren ishin edhe dy ekskavatorë të vegjël të cilët u përfshinë në pastrimin e pasojave në Reçicën e Vogël dhe në Shipkovicë, kurse më 6 gusht si ndihmë plotësuese u dërguan edhe 40 persona nga NP „Higjiena komunale” të cilët u shpërndanë në terren sipas nevojave.

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski vizitoi Tetovën, si dhe vendbanimet Reçica e Madhe, Reçica e Vogël dhe Dobroshte, dhe ndoqi aksionin për pastrimin e pasojave nga përmbytjet. Trajanovski shprehu ngushëllimet deri te familjet të cilat në këtë fatkeqësi humbën të afërmit e tyre.

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e 52-të që u zhvillua në 31 gusht solli Vendim për dhënien e ndihmës për viktimat e vërshimit në Tetovë dhe rrethinë. Me këtë vendim, Qyteti i Shkupit, për të shprehur solidaritet, ndau ndihmë në të holla prej tre milion denarë.



Sivjet janë investuar 31,3 milion denarë për rikonstruksionin e objekteve shkollore

NUK KA MË ÇATI AZBESTI

Për të përmirësuar kushtet në të cilat mësojnë nxënësit e shkollave të mesme, Qyteti i Shkupit gjatë pushimeve verore rinovoi dhe rikonstruktoi objektet në nëntë shkolla të mesme që janë nën kompetencat e tij. Mes tyre, u zëvendësua edhe çatia e vjetër prej azbesti në objektin shkollor dhe në sallën e jashtme të fizikut në SHMQSH "Zdravko Cvetkovski". Me këtë, Qyteti i Shkupit i largoi çatitë e dëmshme prej azbesti



MË PARË



nga të gjitha shkollat e mesme nën kompetencë të tij, që më parë ishin të mbuluara me pllaka azbesti.

- Këtë verë punët ndërtimore u realizuan në nëntë shkolla të mesme, kurse Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti nga buxheti ndau rreth 31,3 milioni denarë. Në SHMQSH „Rade Jovčevski-Korçagin” u zëvendësuan dritaret; në SHMQSH „Cvetan Dimov” u zëvendësua zdrukthëtaria dhe u rinovuan dyshemetë në objektin shkollor; SHMQSH „Pançe Arsovski” u bë me fasadë dhe çati të re; në SHMQSH „Orce Nikolov” u punua në rikonstruksionin e dritareve; në SHMQSH „Nikola Karev” u riparua çatia; në SHMQSH

PASTAJ



SHMQSH „Pançe Arsovski”

NË SHKOLLAT E MESME

„Vlado Tasevski” u rinovuan nyjat sanitare; në SHMQSH „Vëllezërit Miladinov” dhe në SHMQSH „Arseni Jovkov” u rinovua sipërfaqja e oborrit të shkollës; kurse në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski” u zëvendësua çatia e vjetër prej azbesti e objektit shkollor dhe salla e jashtme e fizikulturës dhe u rinovua parketi, gardërobat dhe salla sportive. Gjatë viteve të kaluara, përkatësisht nga viti 2009 deri në vitin 2015, Qyteti i Shkupit për rikonstrukcionin dhe riparimin e shkollave të mesme nga Buxheti ka ndarë rreth 226 milion denarë, gjë me të cilën u kontribua në mënyrë të ndjeshme në përmirësimin e kushteve për punë të nxënësve dhe të kuadrit mësimor – thotë kryetari Koce Trajanovski.

Nga 21 shkollë e mesme e Qytetit të Shkupit, 9 shkolla ishin të mbuluara me material azbesti-çimentoje. Pas analizave dhe përgatitjeve të detajuara, në vitin 2011, Qyteti i Shkupit i zëvendësoi çatitë prej azbesti në SHMQSH „Georgi Dimitrov”, SHMQSH „Rade Jovčevski Korçagin”, dhe në SHMQSH „Arseni Jovkov”. Në vitin 2012 u bënë punime në çatinë e SHMQSH „Vllado Tasevski” dhe në SHMQSH „8-të Shtatori”, kurse në vitin 2013 çatia u zëvendësua në SHMQSH „Josip Broz Tito” dhe në SHMQSH „Cvetan Dimov”. Gjatë pushimit veror në vitin 2014, u zëvendësua çatia e vjetër prej azbesti në SHMQSH „Mihajlo Pupin” dhe në Konviktin „Zdravko Cvetkovski”, kurse këtë verë u intervenua edhe në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”.



Zëvendësim i çatisë të vjetër nga azbesti në SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”



TAKIM NDËRMJET TË PARIT DHE MË TË MIRËVE

Kryetari Koce Trajanovski 25 maturantëve më të mirë – nxënësve të shkëlqyer të gjeneratës 2011/2015 të 21 shkollave të mesme nga Shkupi u ndau mirënjohje dhe shpërblime në para, si pjesë e manifestimit „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve”, që më 18 qershor u mbajt në Teatrin popullor maqedonas.

Fituresit e shpërblimeve dhe mirënjohjeve janë: Valdet Xhemaili nga SHMQSH „Zdravko Cvetkovski”, Anastasija Miovska nga SHMQSH „Marija Kyri- Sklodovska”, Mihaela Kovačeska nga SHMQSH „Josip Broz Tito”, Ljupčo Milenkovski nga SHMQSH „Koço Racin”, Nena Dimitrovska nga SHMQSH „Georgi Dim-

itrov”, Martin Kirov nga SHMQSH „Boro Petrushevski”, Hristina Dimitrovska nga SHMQSH „Vëllezërit Miladinov”, Martina Boskovska nga SHMQSH „Rade Jovčevski Korčagin”, Filip Simonovski dhe Mario Peshevski nga SHMQSH „Mihajlo Pupin”, Jana Vrangaloska nga SHMQSH „Pançe Arsovski”, Martin Iliovski nga SHMQSH „Dr. Pançe Karagjozov”, Elena Merxhanovska nga SHMQSH „Orce Nikolov”, Jasir Islami nga SHMQSH „Zef Lush Marku”, Igor Karanfilovski dhe Nikolçe Trajkovski nga SHMQSH „Llazar Tanev”, Sinan Ismaili nga SHMQSH „Arseni Jovkov”, Sara Gerbevaska nga SHMQSH „Nikolla Karev”, Andrijana Velkovska nga SHMQSH „Vlado Tasevski”, Mimi Spaso-

vaska dhe Dragica Dimčevska nga SHMQSH „Dimitar Vlahov”, Hamit Zekiri nga SHMQSH „Cvetan Dimov”, Dejan Leshnikovski dhe Erxhan Ibraimi nga SHMQSH „8 Shtatori” dhe Emi Veselkoska nga SHMQSH „Vasil Antevski Dren”.

Programi për ndarjen e mirënjohjeve u pasurua me shfaqjen e kuartetit të flauteve „Aulos”, Sara Mejs dhe grupit të vallëzimit të Klubit „Ritam plus”.

Maturantët më të suksesshëm shkuan në ekskursion një ditore të ashtuquajtur „Në gjurmët e krijesve të qytetit” dhe vizituan muzetë dhe monumentet më të rëndësishme të kulturës në Shkup.



U SHPËRBLIEN NXËNËSIT MË TË MIRË

Më 26 qershor të këtij viti kryetari Koce Trajanovski, në ambientet e Qendrës kulturore-informative, u ndau mirënjohje dhe shpërblime nxënësve të klasifikuar më mirë në garat e Shkupit dhe ato regjionale.

- Sot, kremtojmë publikisht dijet e treguara të nxënësve si pjesë e garave në 12 lëndë mësimore të organizuara dhe realizuara nga shoqata të akredituara për organizimin e garave për lëndë të ndryshme mësimore. Qëllimi i garave është thellimi i dijeve të nxënësve në disiplina të caktuara mësimore dhe nxitja e garës konstruktive për arritjen e qëllimeve më të larta arsimore. Është kënaqësi e veçantë për mua që rezultatet nga garat tregojnë se niveli i dijeve tek nxënësit është i lartë – tha kryetari Trajanovski, në ndarjen e shpërblimeve.

Qyteti i Shkupit këtë vit organizoi

për herë të parë projektin për përkrahjen e garave në shumë lëndë mësimore, të cilat u realizuan nga shoqata të akredituara për organizimin e garave në shkollat e mesme

të Qytetit të Shkupit. Për 55 nxënësit e klasifikuar më mirë në garat regjionale të Shkupit u ndanë edhe shpërblime në para në vlerë prej 4.000 denarë.



„VERA E SHKUPIT 2015”

Edicioni i sivjetmë i 36-të i „Vera e Shkupit” që u mbajt nga 21 qershori deri më 31 korrik adhuresve të kulturës dhe artit u afro rreth gjashtëdhjetë programe me koncerte të muzikës klasike, popullore dhe xhaz, shfaqje dramatike, baleti dhe opera, ekspozita dhe projeksione filmike, projekte speciale dhe premiera, në njëzetë skena të ndryshme dhe lokacione të hapura në qytet.

Shkupi më shumë se një muaj pulsoi në ritmin e shqetësimit krijues dhe kreativitetit të artistëve vendas, dhe ishte nikoqir i pothuajse 200 artistëve nga 18 shtete të huaja, nga Japonia, Izraeli, Bullgaria, Greqia, Serbia, Sllovenia, Hungaria, Gjermania dhe Holanda e deri nga SHBA dhe Argjentina.

Manifestimi „Vera e Shkupit” i cili është një event kulturor i mirënjohur i qytetit tonë filloi më 20 qershor me shfaqjen e baletit „Bukuroshet e fjetura” dhe me ekspozitën „Ekstensioni hapësor i artit”. Fundin e këtij festivali e shënoi koncerti “Dhurata nga udhëtimet muzikore” nga Orkestra e dhomës e Rinisë muzikore të Maqedonisë (MMM), në Suli An.



Ky manifestim kulturor tradicional i qytetit u mbajt nën kujdestarinë e Qytetit të

Shkupit dhe Ministrisë së kulturës të Republikës së Maqedonisë.

EKSPOZITË ME FOTOGRAFI NGAZRAELI DHE MAQEDONIA

Më 20 korrik para Qendrës memoriale të Holokaustit të hebrenjve nga Maqedo-

nia, dhe në suazat e „Vera e Shkupit”, u hap ekspozita e fotografive e autorëve Ljupço

Blagoevski nga Maqedonia dhe Keri Hart nga Izraeli, e titulluar „An Israeli eye on Macedonia” dhe “Macedonian eye on Israel”. Ekspozita u organizua me rastin e kremtimit të 20-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Izraelit, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të jashtme të RM-së dhe Ambasadën e Izraelit në vendin tonë.

Autorët Ljupço Blagoevski dhe Keri Hart nëpërmjet objektivit të fotoaparatisë tyre përjetësuan dhe të pranishmëve u prezantuan lidhjen e historisë shekullore dhe të tashmes të dy vendeve tona.



„SHIKO MUZIKË – DËGJO PIKTURË – MERR LIBËR” 2015



Më 23 qershor në Parkun e qytetit, Qendra kulturore për të rinj dhe Filarmonia maqedonase realizuan edicionin e tetë të manifestimit tradicional „Shiko muzikë – dëgjo pikturë – merr libër”.

Organizatorët prezantuan projektin magjepsës „Broduej nën yje” i cili në një mbrëmje para publikut solli hitet vokale dhe instrumentale të filmave muzikorë më të njohur, si „Vallëzimi i paturpshëm”, „Truproja”, „Çikago”, „Magjistari nga Oz”, „Mbreti dhe Unë”, „Oh, Kej”, „Muzikë e vogël nate”, kompozime të cilat shumë kohë parë konsiderohen si xhaz-standarde të mjeshtërive të mëdhenj të muzikës si Gersvin, Roxhers, Arlen, Hamershtajn ose Sandhajm. Publiku kishte mundësi t'i dëgjojë uverturat „Kandid” të Bernshtajn

dhe „Fytyrë qesharake” të Gersvin, si dhe një larmi të hiteve më të njohura të grupit legjendar suedez të muzikës pop „Abba”.

Filarmonia maqedonase u prezantua nën dirigjimin e maestro Borjan Canev, kurse soliste e koncertit ishte lokalistja e mirënjohur Sara Kostadinovska, të cilën publiku muzikor e njeh me emrin Sara Mejs.

Duke ndjekur traditën, edhe këtë herë në ekrane shumë të mëdha, frymëzimin nga muzika e përcollën dy artistë të arteve pamore, piktorët Milan Andov dhe Stojan Gjuriq. Publikut të shumtë në numër iu ndanë 20.000 ekzemplarë të librit „Figura” të novelistit dhe poetit, Jan Neruda.

VAZHDON BASHKËPUNIMI I SHKËLQYER NDËRMJET SHKUPIT DHE NYRENBURGUT

Delegacioni i Qytetit të Shkupit, i kryesuar nga zëvendës-kryebashkiaku Borçe Georgievski, më 2 korrik të këtij viti realizoi takim me delegacionin nga qyteti i binjakëzuar i Nyrenbergut, i kryesuar nga zëvendës-kryebashkiaku i Nyrenbergut, Kristijan Fogel. Në takim u theksua bashkëpunimi shumëvjeçar i frytshëm ndërmjet dy qyteteve, më intensiv në fushën e kulturës, arsimit, sportit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Delegacioni nga qyteti i binjakëzuar i Nyrenbergut arriti në Shkup më 1 korrik me fluturimin e parë të linjës së re ajrore të vendosur ndërmjet dy qyteteve. Në aerodromin „Aleksandar Veliki” delegacioni nga Nyrenbergu u prit nga sekretari i Qytetit të Shkupit, Marjanço Todorovski.

- Dua të shfrytëzoj rastin t'i ftoj qytetarët e Nyrenbergut dhe Gjermanisë të shfrytëzojnë linjat e reja ajrore ekonomike, direkte dhe të vizitojnë Shkupin dhe Maqedoninë dhe të njihen më mirë me shtetin dhe kryeqytetin tonë, kulturën, traditën dhe monumentet kulturore e historike – deklaroi Todorovski.



TURNË NDËRKOMBËTAR PËR TË RINJ NË HENDBOLL 2015



Turneu ndërkombëtar për të rinj në hendboll në sallë, i pesti me radhë „Skopje 2015” u mbajt nga data 13 deri më datën 19 gusht në sallën e sportit „Rasadnik” në Kisela Voda dhe në sallën sportive të SHMQSH „Koço Racin” në Gjorce Petrov.

Në këtë turne hendbolli garuan 20 ekipe nga Maqedonia, Serbia dhe nga Mali i Zi, në konkurrencën për femra dhe meshkuj, ku u arritën rezultatet e mëposhtme:

- Më i miri në gjeneratën e vitit 2000 dhe më të rinj (meshkuj) ishte ekipi i KH „METALURG” SHKUP.
- Më i miri në gjeneratën e vitit 1998 dhe më të rinj (meshkuj) ishte ekipi i KH „METALURG” SHKUP.
- Më i miri në gjeneratën e vitit 1998 dhe më të rinj (femra) ishte ekipi i KH „BAR” – BAR

Organizator i Turneut ndërkombëtar në hendboll në sallë „Skopje 2015” është Klubi i hendbollit „Rabotnički” nga Shkupi. Qyteti i Shkupit është sponsor i turneut dhe përkrah financiarisht organizimin e tij me 70 000 denarë.

„SKOPJE KUP 2015”

Nga data 5 deri më 11 gusht në shumë terrene në Shkup u mbajtën garat e Turneut të dytë ndërkombëtar për të rinj në futboll në sallë në konkurrencën për meshkuj „Skopje Kup 2015”. Këtë vit në turne morën pjesë 32 ekipe nga Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Kroacia dhe Bullgaria me futbollistë të lindur në vitin 1999 dhe më të rinj, dhe të lindur në vitin 2001 dhe më të rinj.



Në këtë turne, më i miri në gjeneratën e vitit 2001 dhe më të rinj ishte ekipi i KF Partizan – Beograd, kurse ekipi më i mirë i gjeneratës 1999 dhe më të rinj ishte, gjithashtu, ekipi i KF Partizan – Beograd.

Turneun ndërkombëtar në futboll Skopje Kup 2015” e organizoi Shoqata „Skopje kup” dhe Federata e futbollit e Maqedonisë. Qyteti i Shkupit përkrahu organizimin e këtij turneu me 100 000 denarë.

MEDALJE PËR MË TË MIRËT NË TURNEUN „SATELIT



u gjend në hartën europiane dhe hyri në kalendarin e Konfederatës së voleybollit europian (CEV), si turne satelit. Në katër vitet e kaluara kishim mundësi të shikojmë garat e çifteve voleybolliste më të mira nga 20 vende nga Europa, si Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Qipro, Çekia, Danimarka, Anglia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Norvegjia, Rusia, San Marino,

Çifti i voleybollit Kosiak/Rudol nga Polonia triumfoi në Turneun e gjashtë ndërkombëtar të voleybollit në rërë „SATELIT SKOPJE 2015” në konkurrencën për meshkuj që u luajt në terrenet e Plazhit të qytetit „Park” nga data 19 deri më datën 23 gusht. Në vendin e dytë në këtë turne u klasifikua

çifti Kocilianos/Zupanis nga Greqia, dhe vendi i tretë i takoi çiftit të voleybollit Koekelkoren/Van Vale nga Belgjika.

- Është kënaqësi e veçantë për mua që në Shkup dhe Republikën e Maqedonisë për herë të parë u mbajt turne në voleyboll i një rangu të tillë të lartë. Ky turne për herë të parë

Serbia, Zvicra, Turqia dhe nikoqiri Maqedonia. Dua të falënderoj Federatën maqedonase të voleybollit për organizimin e shkëlqyer, si dhe sponsorët Telekom i Maqedonisë, BIRRARIA e Shkupit, Sistina dhe gjithsesi, Kryqi i kuq i Qytetit të Shkupit. Shpresoj se vitin e ardhshëm do të kemi nderin të organizojmë



NDËRKOMBËTAR NË VOLEJBOLL NË RËRË SKOPJE 2015"

turneun satelit në voleyboll në rërë edhe në konkurrencën për femra – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, i cili pas ndeshjes finale më 23 gusht ndau medaljet për fituesit e vendit të parë të turneut „SATELIT SKOPJE 2015”.

Medaljet për vendin e dytë i ndau kryetari i Federatës maqedonase të voleybollit, Petar Jovanovski dhe drejtori i Agjencisë për të rinj dhe sport, Marjan Spaseski, kurse medaljet për vendin e tretë i ndau kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva.



Turneu ndërkombëtar i voleybollit në rërë „SATELIT SKOPJE 2015” u luajt para tribunave të mbushura plot e përplot. Fondi i shpërblimeve ishte 8.000 euro. Qyteti i Shkupit përkrahu financiarisht këtë event të rëndësishëm sportiv me një shumë prej 800.000 denarë dhe përkrahje logjistike nga ndërmarrjet publike.

U shënuan 52 - vjet nga tërmeti katastrofik

EKSPOZITA „SHKUPI 1963

Me rastin e shënimit të 52-vjetorit të tërmetit të Shkupit më 26 korrik të vitit 1963 në Muzeun e qytetit të Shkupit u hap ekspozita „Shkupi 1963 – para dhe pastaj”.

- Nga memoria kolektive e shkupjanëve nuk është fshirë 26 korriku i vitit 1963. Shkupi kujton minutat në të cilat kryeqyteti ynë ndjeu fuqinë rrënuese të natyrës. Edhe pas 52 vjetësh nga momentet më tragjike të së kaluarës jo shumë të largët, në shumë familje shkupjane janë të pashlyeshme kujtimet për tërmetin katastrofik dhe të 1.070-të jetëve të humbura. Në gjësimin



e tërmetit mijëra familje humbën shtëpitë e tyre, dhe u dëmtuan rëndë edhe objekte të karakterit publik, siç ishin teatri i vjetër dhe Shtëpia e oficerëve. Lajmi për rrënojat që la tërmeti katastrofik u përhap shpejt në publikun botëror, dhe humanizmi i botës nuk mungoi. Shumë shpejt pas tragjedisë, në qytetin tonë u takuan Lindja dhe Perëndimi që të lehtësojnë dhimbjen dhe vuajtjet e shkupjanëve. Ne edhe sot ju jemi mirënjohës për ndihmën e parë që iu dha qytetarëve tanë, të cilët mbetën pa kushte elementare për një jetë të civilizuar, por edhe për ndërtimin e disa lagjeve të qytetit si zgjidhje afatgjatë për nevojat banesore

të shkupjanëve. Shkupi sot është i njohur si qytet i solidaritetit, gjithsesi për shkak të angazhimit humanitar të shteteve europiane dhe të botës mbarë, por edhe për faktin se shkupjanët së bashku me banorët e tjerë të qyteteve të Maqedonisë, u angazhuan me vetëmohim në dhënien e ndihmës së drejtpërdrejtë banorëve në rrezik, por edhe në ndërtimin e pothuajse një qyteti krejtësisht të ri dhe modern. Në pesëdhjetë vitet e kaluara entuziazmi në zhvillimin dhe ndërtimin e Shkupit nuk është zvogëluar, prandaj Shkupi do të lëvizë me këmbëngulje drejt idealit për tu bërë një kryeqytet modern –

theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e ekspozitës.

Trajanovski shtoi se duke pasur parasysh se nëpër të gjithë historinë e gjatë të Shkupit ka pasur disa fillime të reja, dhe gjithmonë shkupjanët kanë punuar me këmbëngulje për mbijetesën dhe ndërtimin e qytetit të lindjes, është obligim i kësaj gjenerate dhe gjeneratave të ardhshme të kontribuojnë për funksionalitetin e qytetit në të cilin jetojnë dhe punojnë qindra mijëra banorë të Shkupit.

Në ekspozitën „Shkupi 1963 – para dhe pastaj” nëpërmjet zgjedhjes së fotografive u prezantua territori i qendrës së qytetit të Shkupit para dhe pas tërmetit, dhe zhvillimi i saj deri në vitet tetëdhjetë të shekullit kaluar. Fotografitë e prezantuara janë bërë për ekspozitën e realizuar në Muzeun e qytetit



— PARA DHE PASTAJ

të Shkupit në vitet tetëdhjetë të shekullit të XX-të, të titulluar „Fotografi krahasuese të Shkupit“, si dhe fotografi nga Kiro Georgievski, të shfrytëzuara për ekspozitën „Shkupi i vjetër“, të realizuar në Muze në vitin 1993.

Shtojcë e veçantë e ekspozitës ishte donacioni i familjes Bitoljanu i fotografive dokumentare nga fotografi Tomislav Peternek, të fotografuara menjëherë pas tërmetit, gjatë kohës së qëndrimit të tij në Shkup. Tomislav Peternek është një nga

fotografët më të njohur nga Serbia, i cili merret me gazetari, fotografi aplikative, reklamuese, mode dhe nënujore. Shumë vite, përkatësisht deri në daljen në pension ka qenë redaktor i fotografisë në NIN, kurse nga viti 1993 punon si artist i lirë. Është laureat i një numri të madh mirënjohjesh nga vendi dhe ndërkombëtare. Jeton dhe punon në Beograd, Serbi.

Në ekspozitën „Shkupi 1963 – para dhe pastaj“ morën pjesë edhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva dhe Ambasadori i Federatës Ruse në Republikën e Maqedonisë, Oleg Scerbak.



LULE PARA MONUMENTIT TË VIKTIMAVE

Më 26 korrik, në varrezat e qytetit në Butel, delegacione zyrtare dhe përfaqësues të institucioneve vendosën lule para Monumentit të viktimave në tërmetin që ndodhi në para 52 vitesh.

Lule në kujtim të viktimave të tërmetit katastrofik të Shkupit vendosi edhe delegacioni zyrtar i Qytetit të Shkupit, i përbërë nga kryetari Koce Trajanovski dhe kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva, delegacioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, delegacioni i Këshillit të Qytetit të Shkupit, delegacioni i Ministrisë së mbrojtjes së RM-së, si dhe delegacione nga partitë politike, nga të gjitha komunat e Qytetit të Shkupit, nga kori diplomatik në Maqedoni, shoqata civile dhe organizata të tjera.

Lule vendosën edhe delegacione të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve kulturore të Qytetit të Shkupit dhe anëtarë të Kryqit të kuq, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera publike nga vendi në kujtim të viktimave që humbën jetën në tërmetin katastrofik të vitit 1963.



AKSION TRADICIONAL I DHURIMIT TË GJAKUT

Njëqind e katërmëdhjetë qytetarë dhuruan gjak në aksionin tradicional të dhurimit të gjakut, që u mbajt më 26 korrik në Qendrën ditore për dhurimin e gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, në OSHH „Dare Xhambaz“.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit këtë aksion të dhurimit të gjakut e organizoi si pjesë e aktiviteteve për shënimin e përvjetorit të tërmetit katastrofik të Shkupit. Në këtë aksion qytetarët humanë kishin mundësi të dhurojnë gjak dhe të shpëtojnë jetën e dikujt.



Sistem i ri për pagimin e biletave në trafikun publik